



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	15.12.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojç Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK/7495/2023			1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1362/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1023/2023, të datës 24.07.2023, të parashtruar nga ankuesit

të cilët me autorizim përfaqësohen nga firma e avokaturës Kerveshi & Partners, kundër organit të punësimit Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike „*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1362/2023, e datës 31.10.2023, e parashtruar nga ankuesit**
- II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.35/2023, i datës 12.10.2023, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.**

A r s y e t i m

Nëpunësit civil

përmes Postës së Kosovës, me datën 31.10.2023 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KA.nr.35/2023, të datës 12.10.2023, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me pretendimet ankimore që vendimi i kundërshtuar nuk ka mbështetje ligjore dhe arsyeshmëri logjike, ngase në arsyetimin e të njëjtit nuk janë përfshirë fare pretendimet e palëve ankuuese sipas ankesës së datës 24.05.2023, po ashtu theksojnë faktin se KZKA-ja me vendimin e kontestuar fare nuk e ka administruar si provë nxjerrjen e vendimit të datës 06.04.2023 dhe në këtë rast ka bërë shkelje të nenit 48 paragrafit 1 pika 1.3 të LPPA-së. Kërkojnë që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj aktin e kundërshtuar më ankesë, me detyrimin që i njëjti të nxjerrë vendim sipas të cilit e aprovon ankesën e paraqitur nga palët e autorizuara.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 27.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa, ky i fundit, me datë 28.08.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës, ndërsa, pas pranimit të ankesës së datës 31.10.2023, Këshilli nuk ka parashtruar kërkesë për përgjigje në ankesë tek organi i punësimit, meqenëse kanë qenë të përfshira provat lidhur me çështjen në fjalë sipas ankesës të datës 24.07.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova:

Ankesën me numër të protokollit 6790/2023 të datës 31.1.2023 të parashtruar nga grup ankuesish në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KA.nr.35/2023 të datës 12.10.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesën me numër protokollit 5334/2023 të datës 24.07.2023 të parashtruar nga grup ankuesish në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e grupit të ankuesve të datës 12.07.2023 për shoqërinë e avokatëve “Kërveshi & Partners”; Vendimin me numër protokollit 01/897 të datës 20.06.2023 të Komisionit për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Ankesën ndaj heshtjes administrative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me numër protokollit 01/753 të datës 24.05.2023 të parashtruar nga Grupi i ankuesve përmes shoqërisë së avokatëve “Kërveshi & Partners” në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Kërkesën e përsëritur për nxjerrje të vendimit me numër protokollit 09/696 të datës 12.05.2023 të parashtruar nga grupi i ankuesve përmes shoqërisë së avokatëve “Kërveshi & Partners” në Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Kërkesën për nxjerrje të vendimit me numër protokollit 01/505 të datës 06.04.2023 të parashtruar nga Grupi i ankuesve përmes shoqërisë së avokatëve “Kërveshi & Partners” në Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë me numër protokollit 03/457 të datës 24.03.2023 të SKGJK-së; Kërkesën për përmbushje të detyrimit me numër protokollit 01/401 të datës 15.03.2023 të Grupit të ankuesve përmes shoqërisë së avokatëve “Kërveshi & Partners” në Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Vendimin me numër protokollit 03/2142 të datës 29.11.2022 të SKGJK-së; Vendimin me numër reference DS-1172/2022 të datës 29.11.2022 të SKGJK-së; Vendimin me numër protokollit 03/2143 të datës 29.11.2022 të SKGJK-së; Vendimin me numër protokollit 03/2139 të datës 29.11.2022 të SKGJK-së; Vendimin me numër protokollit 03/1754 të datës 29.11.2022 të SKGJK-së; Vendimin me numër protokollit 03/2138 të datës 29.11.2019 të SKGJK-së; Vendimin me numër protokollit 03/2140 të datës 29.11.2022 të SKGJK-së; Aktgjykimin A.nr.2548/18 të datës 29.09.2021 të Gjykatës Themelore Prishtinë; Aktvendimin A.nr.2548/18 të datës 06.10.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimin AA.nr.949/2021 të datës 07.06.2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimin ARJ-UZVP.nr.66/2022 të datës 02.11.2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.07.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 1023 /2023 të datës 28.08.2023 të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përmbushje të detyrimit nga Akt gjykimi A.nr.2548/2018 të datës 09.09.2021 të protokolluar me numër 09/2087 të datës 15.11.2022, të parashtruar nga Grupi ankuesish përmes shoqërisë së avokatëve “Kërveshi & Partners”; Aktgjykimin A.nr.2548/18 të datës 29.09.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Autorizimin e grupit të ankuesve të datës 07.06.2021 për shoqërinë e avokatëve “Kërveshi & Partners”; Tabelën e datës 20.06.2023; 6 Fletë dërgesat e datës 20.06.2023; E-mailin e datës 28.08.2023 të dërguar nga F.K për A.P-SH; Flet pagesën e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për N.V të periudhës 01.12.2022-31.12.2022; Flet pagesën e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për N.V të periudhës 01.01.2023-31.01.2023; Flet pagesën e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për V.L të periudhës 01.12.2022-31.12.2022; Flet pagesën e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për V.L të periudhës 01.01.2023-31.01.2023; Flet pagesën e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për B.N të periudhës 01.12.2022-31.12.2022; Flet pagesën e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për B.N të

periudhës 01.01.2023-31.01.2023; Flet pagesën e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për H.N të periudhës 01.12.2022-31.12.2022; Fletë pagesën e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për H.N të periudhës 01.01.2023-31.01.2023; Fletë pagesën e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për V.K të periudhës 01.12.2022-31.12.2022; Flet pagesën e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për V.K të periudhës 01.01.2023-31.01.2023; Flet pagesën e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për B.K të periudhës 01.12.2023-31.12.2023; Flet pagesën e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për B.K të periudhës 01.01.2023-31.01.2023; Flet pagesën e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për A.H të periudhës 01.12.2023-31.12.2023; Flet pagesën e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për A.H të periudhës 01.01.2023-31.01.2023; Akt emërimin me numër reference GJA.nr.54/17 të datës 01.03.2017 të ankuesit Akt emërimin me numër reference Agj.I.nr.72/2016 të datës 06.05.2016 të ankuesit Akt emërimin e ankuesit të datës 01.09.2017; Akt emërimin me numër GJA.226/17 të datës 31.05.2017 të ankuesit Akt emërimin me numër reference 385/2019 të datës 02.12.2019 të ankueses Akt emërimin me numër reference GJ.A 152/2016 të datës 16.05.2016 të ankuesit Akt emërimin me numër reference GJ.A.501/2016 të datës 14.09.2016 të ankueses . si dhe listat nga libër dorëzimi në postë lidhur me dëshmitë e pranimit të vendimeve nga SKGJK-ja nga ana e ankuesve .

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka vlerësuar se pretendimet ankimore të ankuesve janë të pabazuara, *sepse*:

Nga analizimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesit si në dispozitiv të këtij vendimi janë të punësuar në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (me tej referuar SKGJK) dhe atë; ankuesi sipas Akt emërimit me numër reference GJA.nr.54/17, të datës 01.03.2017, ushtron pozitën Zyrtar certifikues në Gjykatën Themelore në Mitrovicë; ankuesi sipas Akt emërimit Agj.I.nr.72/2016, të datës 06.05.2016, ushtron pozitën Zyrtar certifikues në Gjykatën Themelore në Gjakovë; ankuesi sipas Akt emërimit të datës 01.09.2017, ushtron pozitën Certifikues në Gjykatën Themelore në Prishtinë; ankuesi sipas Akt emërimit GJ.A.226/17, të datës 31.05.2017, ushtron pozitën Zyrtar certifikues në Gjykatën Themelore në Ferizaj; ankuesja sipas Akt emërimit me numër 385/2019, të datës 02.12.2019, ushtron pozitën Zyrtar certifikues në Gjykatën Themelore në Gjilan; ankuesi sipas Akt emërimit GJ.A.152/2016, të datës 16.05.2016, ushtron pozitën Zyrtar certifikues në Gjykatën Themelore në Pejë si dhe ankuesja sipas Akt emërimit GJ.A.501/2016, të datës 14.09.2016, ushtron pozitën Zyrtar certifikues në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Më tej nga provat e çështjes rezulton se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me Aktgjykimin me numër A.nr.2548/18, të datës 09.09.2021, kishte aprovuar si të bazuar kërkesëpaditë e paditësve këtu ankuesve, me ç ‘rast kishe anuluar Vendimin A.nr.484/2018, të datës 18.09.201, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe kishte detyruar Këshillin Gjyqësor të Kosovës, që të zbatoj Vendimin nr.366/2017, të datës 27.11.2017 për harmonizimin e koeficienteve të paditësve nga nëntë (9) në dymbëdhjetë (12) si dhe t’iu kompensoj demin material për shumën e munguar për periudhën nga data 27.12.2017 deri me datë 30.06.2021.

Duke vepruar në procedurë sipas mjeteve juridike, me Aktgjykimin AA.nr.949/2021 të datës 07.06.2022, Gjykata e Apelit ka vërtetuar si të drejtë Aktgjykimin me numër A.nr.2548/18, ndërsa, me Aktgjykimin ARJ-UZVP-nr.66/2022 të datës 25.10.2022, të Gjykatës Supreme, është refuzuar kërkesa e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor.

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në zbatim të vendimeve gjyqësore të specifikuar si më lartë, me Vendimin me reference: DS-1170/2022 të datës 29.11.2022, ankueses Nadire Vllasaliu i ka njohur të drejtën e harmonizimit të koeficientit të pagës nga nëntë (9), në dymbëdhjetë (12), në pozitën Zyrtar certifikues në Gjykatën Supreme të Kosovës dhe kompensimi në

shumën e përgjithshme prej 7,674.85 euro bruto, nga e cila shumë mbulohen pagesat e trustit pensional dhe tatimit në të ardhura në shumën e specifikuar si në aktgjykimin A.nr.2548/2018, për periudhën prej datës 27.12.2017 deri më 30.06.2021; me Vendimin me numër reference DS-1172/2022, të datës 29.11.2022, ankueses i është njohur e drejta e harmonizimit të koeficientit të pagës nga nëntë (9) në dymbëdhjetë (12), në pozitën Zyrtar certifikues në Gjykatën Themelore në Gjilan, dhe kompensimi në shumën e përgjithshme prej 7,674.85 euro bruto, nga e cila shumë mbulohen pagesat e trustit pensional dhe tatimit në të ardhura në shumën e specifikuar si në aktgjykimin A.nr.2548/2018, për periudhën prej datës 27.12.2017 deri më 30.06.2021; me Vendimin me numër reference DS-1175/2022, të datës 29.11.2022, ankuesit i është njohur e drejta e harmonizimit të koeficientit të pagës nga nëntë (9), në dymbëdhjetë (12), në pozitën Zyrtar certifikues në Gjykatën Themelore në Pejë, dhe kompensimi në shumën e përgjithshme prej 7,674.85 euro bruto, nga e cila shumë mbulohen pagesat e trustit pensional dhe tatimit në të ardhura në shumën e specifikuar si në aktgjykimin A.nr.2548/2018, për periudhën prej datës 27.12.2017 deri më 30.06.2021; me Vendimin me numër reference DS-1176/2022, të datës 29.11.2022, ankuesit i është njohur e drejta e harmonizimit të koeficientit të pagës nga nëntë (9), në dymbëdhjetë (12), në pozitën Zyrtar certifikues në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe kompensimi në shumën e përgjithshme prej 7,674.85 euro bruto, nga e cila shumë mbulohen pagesat e trustit pensional dhe tatimit në të ardhura në shumën e specifikuar si në aktgjykimin A.nr.2548/2018, për periudhën prej datës 27.12.2017 deri më 30.06.2021; me Vendimin me numër reference DS-1171/2022, të datës 29.11.2022, ankuesit i është njohur e drejta e harmonizimit të koeficientit të pagës nga nëntë (9) në dymbëdhjetë (12), në pozitën Zyrtar certifikues në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe kompensimi në shumën e përgjithshme prej 7,674.85 euro bruto, nga e cila shumë mbulohen pagesat e trustit pensional dhe tatimit në të ardhura në shumën e specifikuar si në aktgjykimin A.nr.2548/2018, për periudhën prej datës 27.12.2017 deri më 30.06.2021, me Vendimin me numër reference DS-1174/2022, të datës 29.11.2022, ankuesit i është njohur e drejta e harmonizimit të koeficientit të pagës nga nëntë (9) në dymbëdhjetë (12), në pozitën Zyrtar certifikues në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe kompensimi në shumën e përgjithshme prej 7,674.85 euro bruto, nga e cila shumë mbulohen pagesat e trustit pensional dhe tatimit në të ardhura në shumën e specifikuar si në aktgjykimin A.nr.2548/2018, për periudhën prej datës 27.12.2017 deri më 30.06.2021; me Vendimin me numër reference DS-1173/2022, të datës 29.11.2022, ankuesit i është njohur e drejta e harmonizimit të koeficientit të pagës nga nëntë (9) në dymbëdhjetë (12), në pozitën Zyrtar certifikues në Gjykatën Themelore në Gjakovë dhe kompensimi në shumën e përgjithshme prej 7,674.85 euro bruto, nga e cila shumë mbulohen pagesat e trustit pensional dhe tatimit në të ardhura në shumën e specifikuar si në aktgjykimin A.nr.2548/2018, për periudhën prej datës 27.12.2017 deri më 30.06.2021.

Tutje, nga shkresat e lëndës rrjedhë së ankuesit më datë 15.03.2023, 06.04.2023, dhe 12.05.2023, përmes përfaqësuesit me autorizim kanë parashtruar kërkesë për njohjen e kompensimit të diferencës së koeficientit nga 9 nëntë (9) në dymbëdhjetë (12) dhe atë në mënyrë retroaktive nga data 30.06.2021 deri me datë 25.10.2022, përfshirë edhe pagesën e trustit pensional dhe tatimin në të ardhura personale. Ndërsa, Organi i punësimit gjegjësisht Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore të SKGJK-së, përmes përgjigjes së datës 24.03.2023 ka njoftuar ankuesit se KGJK-ja në plotëni ka përmbushur detyrimet sipas Aktgjykimit A.nr.2548/18, të datës 09.09.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesit, me datën 24.05.2023, kanë parashtruar ankesë pranë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së, po me bazë të njëjtë ankimore, kurse, ky i fundit me Vendimin KA.nr.16/2023, të datës 20.06.2023, ka refuzuar ankesën e ankuesve si të pa bazuar.

Këshilli duke vendosur sipas ankesës së ankuesve të datës 24.07.2023, të parashtruar kundër Vendimit KA.nr.16/2023, me Vendimin A.nr.1023/2023 të datës 20.09.2023, ka shfuqizuar Vendimin me numër KA.nr.16/2023, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë, me obligimin që ky i fundit të ri shqyrtoj ankesën

e palëve ankuese të datës 25.04.2023 dhe të nxjerrë vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi duke marrë parasysh pikëpamjet juridike si në arsyetimin e po të njëjtit vendim.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në SKGJK-së në riprocedurë me Vendimin me numër KA.nr.35/2023 të datës 12.10.2023 ka refuzuar si të papranueshme ankesën e ankuesve me numër Nr.01/753 të datës 24.05.2023, mbi bazën së ankesa është parashtruar jashtë afatit ligjor.

Ankuesit sërish kundërshtojnë Vendimin me numër KA.nr.35/2023 të datës 12.10.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me pretendimet ankimore që vendimi i kundërshtuar nuk ka mbështetje ligjore dhe arsyeshmëri logjike, ngase në arsyetimin e të njëjtit nuk janë përfshirë fare pretendimet e palëve ankuese sipas ankesës së datës 24.05.2023, po ashtu theksojnë faktin se KZKA-ja me vendimin e kontestuar fare nuk e ka administruar si provë nxjerrjen e vendimit të datës 06.04.2023 dhe në këtë rast ka bërë shkelje të nenit 48 paragrafit 1 pika 1.3 të LPPA-së. Kërkojnë që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj aktin e kundërshtuar më ankesë, me detyrimin që i njëjti të nxjerrë vendim sipas të cilit e aprovon ankesën e paraqitur nga palët e autorizuara.

Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës së ankuesve, Kolegji i Këshillit i ‘u referua nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin është përcaktuar se: *1. Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj.*” si dhe nenit 127 të të njëjti ligj parashihet se: *“1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ...”*. Andaj, nisur nga ky përcaktim ligjor dhe bazuar në provat materiale të kësaj çështje administrative, Kolegji konstatoi se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.35/2023 të datës 12.10.2023 i atakuar me ankesë, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, sepse, bazuar në dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit konstatohet se: ankuesja Vendimin me numër reference: DS-1170/2022 të datës 29.11.2022, dhe numër të protokollit 03/2143, e ka pranuar me datë 01.12.2022, ankuesi


Vendimin me numër reference DS-1171/2022, të datës 29.11.2022 dhe numër të protokollit 03/2142, e ka pranuar me datë 01.12.2022, ankuesi Vendimin me numër reference DS-1176/2022, të datës 29.11.2022 dhe numër të protokollit 03/1754, e ka pranuar më datë 07.12.2022; ankuesi Vendimin me numër reference DS-1174/2022, të datës 29.11.2022 dhe numër të protokollit 03/1239, e ka pranuar me datë 05.12.2022, ankuesja Vendimin me numër reference DS-1172/2022, të datës 29.11.2022 dhe numër të protokollit 03/2141, e ka pranuar më datë 01.12.2022, ankuesi Vendimin me numër reference DS-1175/2022, të datës 29.11.2022 dhe numër të protokollit 03/2138, e ka pranuar me datë 02.12.2022, ankuesi Vendimin me numër reference DS-1173/2022, të datës 29.11.2022 dhe numër të protokollit 03/2140, e ka pranuar më datë 07.12.2022, ndërsa, të njëjtit deri me datë 24.05.2023 nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim juridik (ankesë) për të kundërshtuar ligjshmërinë e këtyre vendimeve, kështu që, mbi këtë bazë rrjedhë së ankesa e ankuesve e parashtruar më datë 24.05.2023 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së, është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht, pretendimet ankimore të ankuesve sipas ankesës A.nr.1362/2023 të datës 31.10.202, janë të pabazuara.

Theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë

konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1362/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesve me autorizim të ankuesve
- Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të SKGJK-së;
- Arkivit të KPMSHCK-së.